



Banka e vendit tënd




Kodi I  
Mirësjelljes

# Table of Contents

|                                                                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Qëllimi .....                                                                                                       | 03 |
| Zbatimi I Kodit Të Mirësjelljes .....                                                                               | 04 |
| Misioni I Bankës .....                                                                                              | 05 |
| Vizioni I Bankës .....                                                                                              | 06 |
| Vlerat Tona .....                                                                                                   | 07 |
| Jemi Të Orientuar Ndaj Klientit .....                                                                               | 08 |
| Ne Veprojmë Me Integritet .....                                                                                     | 08 |
| Ne Marrim Përgjegjësi .....                                                                                         | 08 |
| Ne Vazhdimisht Mbështesim Zhvillimin Dhe Avancimin .....                                                            | 09 |
| Ne jemi të përkushtuar që transparencën ta bëjmë bazën e veprimeve tona dhe të inkurajojmë komunikim të hapur ..... | 09 |
| Rregullat Dhe Parimet .....                                                                                         | 10 |
| Marrëdhënia Me Të Punësuarit .....                                                                                  | 11 |
| Shëndeti Dhe Siguria Në Punë .....                                                                                  | 12 |
| Mbrojtja E Aseteve Të Bankës .....                                                                                  | 13 |
| Ryshfeti, Korrupsioni Dhe Pranimi I Dhuratave .....                                                                 | 14 |
| Marrëdhënia Me Klientët E Bankës .....                                                                              | 15 |
| Siguria dhe privatësia e klientit, të dhënat dhe konfidencialiteti .....                                            | 16 |
| Mbrojtja E Të Dhënave .....                                                                                         | 16 |
| Konflikti I Interesit .....                                                                                         | 16 |
| Pajtueshmëria me ligjet, dhe rregullorët në fuqi dhe dokumentet e brendshme të bankës .....                         | 17 |
| Lufta Kundër Krimin Financiar .....                                                                                 | 17 |
| Komunikimi Me Palë Të Tjera .....                                                                                   | 18 |
| Rregullat E Mirësjelljes Në Raport Me Konkurrentët .....                                                            | 19 |
| Përgjegjësia Sociale Dhe Mjedisore .....                                                                            | 19 |
| Përgjegjësia Për Të Raportuar Sjellje Të Papranueshme .....                                                         | 20 |

# Qëllimi



Banka për Biznes (BPB) promovon standardet më të larta të sjelljes etike dhe profesionale. Kodi i mirësjelljes përcakton parimet dhe rregullat themelore të sjelljes që duhet të zbatohen nga të gjithë punonjësit e Bankës, pa përjashtim, në çdo situatë të punës. Punonjësit e Bankës duhet të respektojnë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes etike, duke vepruar gjithmonë me ndershmëri dhe korrektësi.

Kodi ynë i Mirësjelljes zbatohet për çdo gjë dhe për të gjithë ne në BPB. Ai është në pronësi të secilit prej nesh, dhe çdo punonjës është personalisht përgjegjës për ta kuptuar atë, respektuar dhe aplikuar në raport me njëri-tjetrin, klientët tanë, rregullatorët, partnerët e biznesit, aksionarët, konkurrentët dhe palët e tjera.

Ky Kod përbën bazën e të gjitha politikave, procedurave dhe udhëzimeve të BPB-së, të cilat janë në përputhje me praktikatat më të mira vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë nuk mund të përshkruaj çdo situatë të mundshme, ai vendos standardet themelore të sjelljes që udhëheqin veprimet dhe vendimmarrjen tonë.



# Zbatimi i Kodit Të Mirësjelljes

Të gjithë të punësuarit e Bankës, duhet të veprojnë sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara në Kodin e Mirësjelljes.

Rregullat dhe standardet e përcaktuara me këtë Kod, janë pjesë e kushteve të përgjithshme të punësimit. Përveç kësaj, disa nga obligimet e përcaktuara në Kod Mbeten të vlefshme edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Bankën.

Shkeljet eventuale të Kodit të Mirësjelljes, do të shqyrtohen dhe do të merren masa bazuar në procedurat e brendshme të Bankës. BPB inkurajon punonjësit të adresojnë shqetësimet, pyetje apo probleme të mundshme ligjore ose etike tek Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.

# Misioni | Bankës

*"Ne ndikojmë pozitivisht"*

Ne besojmë se çdo individ dhe biznes meriton një shërbim të përkryer. Shërbim i përkryer nënkupton ofrimin e zgjidhjeve të shpejta, profesionale dhe të kujdesshme që lehtësojnë përvojën e klientit.

# Vizioni | Bankës

Vizioni i BPB-së është të jemi Banka me shërbimin më të mirë në treg – Banka që kryen punë!. Ne synojmë të jemi referente për individët dhe ndërmarrjet në Kosovë, duke ofruar komoditet dhe mbështetje proaktive. Ne synojmë të bëhemi faktor kyç në zhvillimin e sektorit bankar të Kosovës, të ofrojmë një shërbim të shkëlqyeshëm për klientët tanë, fitim të qëndrueshëm për aksionarët dhe një ambient pune frymëzues për punonjësit. Përderisa konsiderojmë teknologjinë një domosdoshmëri, ne besojmë në fuqinë e faktorit njerëzor në përmbushjen e kërkesave të klientëve tanë dhe palëve të interesuara.

# Vlerat Tona

Vlerat tona udhëheqin çdo veprim dhe vendim, nga orientimet strategjike deri te ndërveprimet e përditshme me klientët dhe kolegët tanë. Ato përbëjnë bazën e kulturës sonë organizative dhe përcaktojnë standardet e sjelljes që ne promovojmë.

***Ofrimi ishërbimit të përkryer dhe të vepruarit drejtë***  
janë elementet kryesore që përcaktojnë identitetin dhe zhvillimin e BPB-së.

## Jemi të orientuar ndaj klientit

Përkushtimi ynë në ofrimin e zgjidhjes efikase dhe të përshtatshme për klientin, dëshmon orientimin tonë ndaj tij. Ne besojmë që shërbimi financiar është utilitet bazë dhe nuk është i rezervuar për një grup klientësh. Prandaj, shërbimi ynë vihet në dispozicion të çdo individi dhe biznesi që përmbush nevojat rregullatore për qasje në llogari bankare dhe plotëson kushtet e bashkëpunimit sipas standardeve të Bankës. Ne sigurohemi që produktet dhe shërbimet tona për klientët të plotësojnë nevojat e klientëve tanë, duke ofruar zgjidhje praktike dhe ekonomike. Kjo përfshinë të kuptuarit drejtë dhe përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive të klientëve përmes shërbimit të shkëlqyer, komunikimit të hapur dhe reagimit në kohë ndaj nevojave të tyre. Kjo kulturë ndikon në rritjen e kënaqësisë së klientit, besimit në institucionin dhe ndërtimin e marrëdhënieve të forta dhe afatgjata që si rezultat nxisin rritjen e institucionit. Ne vazhdimisht investojmë në teknologji të reja për të përmbushur kërkesat e klientëve për shërbim dixhital, mirëpo gjithmonë ofrojmë edhe mbështetje nga stafi ynë ashtu që të mundësojmë këshilldhënie adekuate dhe të japim opsione për mënyrën e shërbimit sipas preferencave të klientit.

## Ne veprojmë me integritet

Duke vepruar me integritet, ne sigurohemi që çdo vendim që marrim të jetë i bazuar në parime etike. Besimi dhe sinqeriteti janë elementet kyçe në bazë të të cilave ne veprojmë. Ajo që e presim nga punonjësit tanë është të vepruarit me integritet, të jenë të përgjegjshëm, të besueshëm dhe t'i trajtojnë pandashëm me respekt kolegët, aksionarët dhe klientët.

## Ne marrim përgjegjësi

Ne veprojmë me përgjegjësi në marrëdhënie me klientin, stafin dhe shoqërinë në tërësi. Përderisa ne jemi një organizatë fitimprurëse, ne tentojmë që t'i arrijmë aspiratat tona biznesore, gjithmonë duke ofruar një vlerë të shtuar për klientët tanë. Ne e sigurojmë këtë duke i këshilluar klientët tanë në ofrimin e zgjedhjes më të mirë në bazë të interesave të tyre.

Në marrëdhënie me stafin tonë, ne i trajtojmë ata në mënyrë të drejtë, investojmë vazhdimisht në zhvillimin e tyre dhe sigurojmë një mjedis ku ata mund të kontribuojnë në objektivat e Bankës, dhe në të njëjtën kohë të arrijnë qëllimet e tyre profesionale. Ne promovojmë ekuilibrin “punë–jetë” dhe sigurojmë kapacitete të mjaftueshme të stafit për të arritur këtë gjë.

Ne marrim përgjegjësi edhe për shoqërinë tonë dhe e shohim impaktin tonë kryesisht në tri shtylla: sigurojmë qasje të lehtë dhe ekonomike në shërbimet financiare për çdo individ të shoqërisë; investojmë në edukimin dhe këshillimin financiar të bizneseve, dhe tentojmë të jemi aktiv në shoqëri duke mbështetur aktivitete të ndryshme nëpërmjet punës vullnetare dhe kontributit financiar të drejtpërdrejtë.

## **Ne vazhdimisht mbështesim zhvillimin dhe avancimin**

Ne jemi një institucion agjil dhe i adaptueshëm që promovon një kulturë të reflektimit sistematik mbi mundësitë e zhvillimit të cilat ndikojnë në rritjen e kapacitetit të brendshëm, rritjen e brendit tonë si dhe rritjen e pranisë sonë në treg. Komponentët tanë kryesorë me fokus zhvillimin janë: përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve që ofrohen për klientët tanë dhe investimi në ndërtimin e kapacitetit të punonjësve të aftë të cilët adaptohen në mjedis të ndryshueshëm.

## **Ne jemi të përkushtuar që transparencëta bëjmë bazën e veprimeve tona dhe të inkurajojmë komunikim të hapur**

Qëllimi ynë është që të kemi një mjedis pune ku besimi ndaj njëri-tjetrit është element kyç i bashkëpunimit të shëndoshë. Për ta arritur këtë, ne jemi transparent ndaj njëri-tjetrit dhe palëve të treta duke e dhënë informacionin e nevojshëm, të qartë dhe në kohë.

Objektiv i përbashkët është krijimi i një mjedisi të besueshëm, ku secili ndjehet i lirë që ta shprehë opinionin e tij, tolerohen dallimet dhe të promovohet diversiteti. Të punësuarit inkurajohen të raportojnë çfarëdo shkelje apo përceptim të shkeljes së këtij kodi, dhe sigurohen që nuk do të ndëshkohen për një gjë të tillë edhe në rastet kur situata e përceptuar nuk është e bazuar për tu cilësuar si shkelje.

# Rregullat dhe Parimet

Ne jemi të përkushtuar të nxisim sjelljen e duhur duke definuar parime dhe rregulla të veprimit, që janë obligative për secilin të punësuar dhe në çdo situatë. Rregullat dhe parimet e definuara në Kodin e mirësjelljes na mundesojnë të jetësojmë vlerat tona. Është e rëndësishme që të sigurohemi që veprimet tona të mbështesin vlerat e Bankës, dhe të shmangim situatat kur ato veprimet cenojnë parimet e të vepruarit drejtë.

Për të ndihmuar punonjësit tanë në marrjen e vendimeve të duhura kur përballen me pasiguri, ata duhet të marrin parasysh modelin e pyetjeve të paraqitura në vijim:

- *A është vendimi apo veprimi i ligjshëm?*
- *A është vendimi apo veprimi në përputhje me politikat, procedurat dhe/ose udhëzimet e vendosura nga Banka?*
- *A shton vlerë vendimi/veprimi që marr/bëj?*
- *A do të arsyetoni lirshëm marrjen e këtij veprimi para kolegëve, menaxherëve dhe familjes suaj?*
- *A është një shembull i mirë për kolegët tuaj në Bankë?*
- *A do të ndiheshit rehat nëse të tjerët do të kuptonin për veprimin që keni ndërmarrë?*

Nëse i jeni përgjigjur me "po" pyetjeve të mësipërme, atëherë ju karakterizon një etikë e mirë pune. Në rast hezitimi apo çfarëdo paqartësi (nëse ndonjëra nga përgjigjet nuk është "po") punonjësit udhëzohen të kontaktojnë mbikëqyrësin direkt apo Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimeve.



## Marrëdhënia me të punësuarit

Në BPB ne vlerësojmë ndryshimin, përkrahim diversitetin dhe përfshirjen. BPB është e përkushtuar ndaj komunikimit të hapur dhe mundësive të barabarta për të gjithë. Ne kërkojmë nga punonjësit të trajtojnë njëri-tjetrin me dinjitet dhe respekt, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës. BPB nuk toleron veprime të pasjellshme, diskriminim, ngacmim, viktimizim ose bullizm, dhe çfarëdo lloj sjellje kërcënuese, armiqësore ose abuzive që cenojnë dinjitetin dhe mirëqenien e punonjësve. Çdo sjellje e tillë, trajtohet me procedura disiplinore.

Ne jemi të përkushtuar të bashkëpunojmë pa diskriminuar racën, ngjyrën, gjininë, origjinën kombëtare, etnicitetin, moshën, besimin, aftësinë, statusin martesor, shtatzëninë, orientimin seksual, identitetin, shtetësinë ose çdo karakteristikë të mbrojtur nga ligji. Kultura jonë është e ndërtuar mbi mikpritjen, respektin dhe vlerësimin e secilit punonjës, duke krijuar një mjedis pune të sigurt, të drejtë dhe mundësi të barabarta suksesi.

# Shëndeti dhe siguria në punë

Kujdesi për shëndetin dhe sigurinë në punë për punonjësit tanë, është një çështje tjetër me shumë rëndësi. Ne jemi të përkushtuar ndaj një mjedisi pune që mbron shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e të gjithëve. Si rrjedhojë, ne nuk tolerojmë asnjë kompromis ndaj shëndetit dhe sigurisë së të tjerëve, dhe nuk vendosim objektivat tona strategjike si më të rëndësishme se shëndeti dhe mirëqenia e atyre me të cilët punojmë.



# Mbrojtja e aseteve të Bankës

Çdo punonjës në BPB obligohet të trajtoj me përgjegjësi të plotë të gjitha asetet, paisjet, pronat, dhe të dhënat e Bankës. Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur të gjitha format e të dhënave, informacionit dhe pasurive duke i përdorur ato arsyeshëm, dhe në harmoni me procedurat dhe rregullat e shfrytëzimit të tyre. Secili përdorues i aseteve të bankës, duhet të sigurohet që përdorimi i tyre të jetë sa me ekonomik dhe në funksion të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të bankës;

Asetet e bankes përfshijnë asetet fizike dhe informative duke përfshirë por pa u limituar në paisjet 'harduerike' dhe 'softuerikbre', mjetet e ndryshme të punës dhe transportit, paratë e gatshme, dokumentet e brendshme të bankës, informatat mbi klientet, analizat e ndryshme, metodologjitë e punës, planet e biznesit e të ngjashme.

Si udhezues për mbrojtjen e aseteve të bankes, me poshte disa rregulla të rëndësishme:

- *Kopjimi, shitja, qasja e pa-autorizuar apo shpërndarja e informatave, softwereve dhe formave tjera intelektuale pa licencë të rregullt është e ndaluar;*
- *Përdorimi i e-maileve, telefonit dhe mjeteve tjera të komunikimit bëhet për qëllim biznesi. Komunikimet private duhet të mbahen në minimum;*
- *Çfarëdo dyshimi për humbje apo keqpërdorim të aseteve të bankës, duhet të raportohet;*
- *Asetet informative të bankes vihen në dispozicion vetëm për të arritur qëllimet operacionale/ biznesore të bankës dhe nuk duhet të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç situatave kur një gjë e tillë është aprovuar me vendim të autoritetit vendim-marrës apo kur asetet e tilla u vihen në dispozicion organeve të rendit apo gjykatës;*
- *Në rast të ndërprerjes së përkohshme apo të përhershme të kontratës së punës, të gjitha asetet e vëna në dispozicion duhet të dorëzohen;*
- *Asetet intelektuale të bankes duke përfshirë edhe brandin duhet të përdoren vetëm për të arritur qëllimet e bankës dhe jo për ndonjë qëllim tjetër jo zyrtar/ personal;*
- *Të gjithë të punësuarit duket t'i përmbahen strikt politikës së privatësisë në lidhje me informatat që na vihen në posedim, qofshin ato të klientëve, kolegeve apo të palëve tjera me të cilat në ndërveprojmë;*
- *Nuk lejohet përdorimi i emrit të bankës, shërbimeve apo pozitës në bankë për të arritur qëllime private, apo përfitime personale, apo për të apo për të mbështetur ndonjë produkt, organizatë apo qëllim që nuk ka të bëjë me biznesin e bankës;*

# Ryshfeti, korrupsioni dhe pranimi i dhuratave

Çfarëdo forme e ryshfetit apo korrupsionit si ofrimi, pranimi, autorizimi, kerkimi, premtimi në mënyrë direkte apo indirekte e çfarëdo vlere një zyrtari qeveritar apo personi privat me qëllim të përfitimit apo mbajtjes së biznesit është e ndaluar.

Punonjësit nuk duhet të pranojnë ose të ofrojnë asnjë benefit personal (çoftë monetar apo jo monetar) që mund të bie ndesh me detyrat e punës. Këtu përfshihen parat, dhurata, udhëtime, çmime, argëtim, rekreacion, evente apo të ngjashme. Të punësuarit mund të pranojnë apo ofrojnë vetëm dhurata simbolike, duke qenë subjekt i kritereve dhe aprovimeve të vendosura në rregullat tona të brendshme. Dhuratat në formë të parasë së gatshme, nuk lejohet të jepen apo pranohen në asnjë rrethanë.



# Marrëdhënia me klientët e Bankës

Si Bankë, ne kemi përcaktuar klientin në qendër të mënyrës se si e drejtojmë biznesin tonë. Pjesë e rëndësishme e suksesit tonë, është krijimi i vlerës për klientët tanë nga zgjidhjet që ofrojmë dhe shërbimet që japim. Ne punojmë me përkushtim për të përmbushur nevojat e klientit tonë duke vepruar me ndershmëri, korrektësi, profesionalizëm dhe në përputhje me interesat e klientëve tanë.

Të punësuarit e Bankës, kanë eksperiencën e duhur dhe trajnohet në atë mënyrë që të ofrojnë shërbime sa më cilësore dhe në kohë për të gjithë klientët. Është me rëndësi që punonjësit në komunikim me klientët tanë, qoftë në të shprehura me gojë apo të shkruara, të kenë komunikim të drejtë, të qartë dhe të saktë. Të gjithë të punësuarit e Bankës janë të udhëzuar që të komunikojnë në mënyrë transparente me klientët dhe të trajtojnë çdo kërkesë apo ankesë eventuale që mund të ngritet nga ana e tyre.



## Siguria dhe privatësia e klientit, të dhënat dhe konfidencialiteti

Ne ruajmë dhe trajtojmë me kujdes të shtuar çdo të dhënë personale dhe konfidenciale, informacion apo asete që klientët kanë ndarë me ne. Gjatë punës së tyre, të gjithë punonjësit duhet t'i trajtojnë si konfidenciale informacionet që i janë besuar BPB-së nga klientët tanë dhe punonjësit e tjerë. Kjo përfshinë çdo lloj informacioni si të dhëna lidhur me gjendjen financiare, në lidhje me menaxhimin e biznesit, planet e ardhshme të bizneseve të klientëve tanë, apo informacionet të tjera të marra gjatë periudhës së punës.

Punonjësit nuk duhet të zbulojnë informacione konfidenciale askujt brenda ose jashtë BPB-së, përveç nëse janë në përputhje me procedurat dhe politikat e mbrojtjes së të dhënave personale, ligjet dhe rregulloret në fuqi, ose në rastet kur është specifikisht e lejuar prej tyre. Detyrimet individuale të punonjësve tanë për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit vazhdojnë edhe pasi ata largohen nga institucioni.

## Mbrojtja e të dhënave

Në rrjedhën e detyrave, disa punonjës mbledhin, përdorin dhe marrin informacion personal mbi të punësuarit tjerë, klientët tanë ose bashkëpunëtorëve. Këto informacione, duhet ti ruajmë dhe trajtojmë në përputhje me ligjet e mbrojtjes së të dhënave, politikat tona dhe çdo obligim kontraktual.

## Konflikti i interesit

Konflikti i interesit paraqet situatat kur interesat tona të ndryshme personale, miqësore, familjare apo politike na vënë në situatë që mund të komprometojë apo krijojë përceptimin komprometimit të vendimit apo veprimit në punë.

Në BPB, jemi të përkushtuar të mbajmë veten përgjegjës për të identifikuar dhe menaxhuar konfliktet e mundshme të interesit, duke i shqyrtuar dhe trajtuar ato menjëherë.

Secili prej nesh duhet të sigurojë që interesat personale të mos jenë në konflikt ose të përceptohen në konflikt me detyrat dhe detyrimet tona ndaj bankës dhe klientëve tanë. Punonjësit nuk duhet të përfshihen në asnjë transaksion, negociim ose kontratë me një njësi ekonomike në të cilën punonjësi ose ndonjë palë e lidhur ka një interes, përveç rasteve kur kjo përfshirje është miratuar në mënyrë specifike pas zbulimit të situatës së konfliktit të interesit. Ne shmangim konfliktet midis interesave personale, sociale, financiare ose politike. Për shembull, ne nuk do të marrim pjesë në miratimin e sponsorizimit për një klub ku jemi anëtarë, ose në miratimin e një kredie biznesi për entitetin ku kemi punuar më parë. Nëse një punonjës, gjatë punësimit në BPB, has në një konflikt të mundshëm interesi, ai duhet ta deklarojë atë.

## **Pajtueshmëria me ligjet, dhe rregullorët në fuqi dhe dokumentet e brendshme të Bankës**

Qëllimi ynë është që të rritemi dhe të realizojmë strategjinë tonë të biznesit në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme në raport me tregun, autoritetet dhe ligjet, dhe rregulloret në fuqi. Ne gjithashtu, jemi të përkushtuar që gjithmonë të bashkëpunojmë me organet përkatëse rregullatore. Të punësuarit e Bankës, duhet të respektojnë politikat dhe procedurat e brendshme të Bankës, ligjet dhe kërkesat rregullatore të aplikueshmen për fushën të cilën ata e mbulojnë.

## **Lufta kundër krimit financiar**

BPB nxit zhvillimin e rregullave të shëndosha dhe procedurave të brendshme për të luftuar krimin financiar. Ne kujdesemi të jemi në përputhje më të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat parandalojnë vepra të tilla si pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Lehtësimi apo neglizhimi i çfarëdo akti që mund të mundësojë pastrimin e parave të përfituara jo ligjshëm është i ndaluar. Parandalimi i aktivitetetve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit kërkon dilgjencë të shtuar në me sa vijon: të informohemi dhe të implementojmë politikën dhe procedurën e PPP/LFT-së, si dhe instrukcionet e marra gjatë trajnimit të rregullt të PPP/LFT-s së; të jemi vigjilent në njohjen e klientit/furnitorit apo të palës tjetër me të cilin koepërojmë, si dhe në analizën e transaksioneve që kryhen në bankë; të raportojmë me kohë çfarëdo shqetësimi apo informate që mund të kemi dhe që mund të parandalojë një aktivitet të tillë.



# Komunikimi me palë të tjera

Komunikimi zyrtar me media apo të ngjashmë mund të bëhet vetëm nga punonjës të caktuar të Bankës. Punonjësëve të tjerë nuk iu lejohet të përfshihen në emër të BPB-së, në ndonjë aktivitet publik apo deklaratë pa pasur aprovimin nga Sektori i Marketingut. Nëse ndonjë i punësuar kontaktohet direkt nga ndonjë media për prononcim rreth ndonjë çështjeje në lidhje me Bankën, atëherë obligohet që paraprakisht të marrë aprovimin nga personat përgjegjës.

## Rregullat e mirësjelljes në raport me konkurrentët

Të punësuarit e Bankës udhëzohen që të veprojnë në mënyrë profesionale, të drejtë dhe me integritet të lartë, në raport me të gjithë konkurrentët. Ne zotohemi të konkurojmë me praktikat më të mira për performancë dhe me mirësjellje, në përputhje me rregullat e konkurrencës së drejtë.

## Përgjegjësia sociale dhe mjedisore

Në përputhje me një ndër vlerat tona dhe bazuar në parimet e qëndrueshmërisë sonë, ne jemi të përkushtuar të konsiderojmë efektet afatgjata të aktiviteteve tona dhe të prodhojmë vlerë të qëndrueshme për klientët, punonjësit, aksionarët dhe shoqërinë në tërësi.

Kjo do të thotë që ne konsiderojmë dhe vlerësojmë aspektet dhe ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vendimeve tona. Ne përpiqemi të rrisim ndikimin pozitiv të vendimeve tona të biznesit dhe të mbështesim një të ardhme të qëndrueshme për shoqërinë dhe mjedisin.



# Përgjegjësia për të raportuar sjellje të papranueshme

Është përgjegjësi e çdo punonjësi të raportoj në rast se dyshon sjellje të paligjshme, joetike, ose thjesht shkelje e këtij Kodi ose ndonjë politike tjetër të Bankës. Pavarësisht nëse keni evidentuar veprimin personalisht , apo është informacion që keni marrë nga dikush tjetër, është detyra juaj të raportoni atë për të mundësuar trajtimin e duhurat sjelljes së gabuar nga ana e Bankës.

Ka disa mënyra si mund të adresoni shqetësimet tuaja:

- ***Të raportoni shqetësimin/ çështjen tek mbikëqyrësi juaj;***
- ***Të raportoni shqetësimin/ çështjen tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, Udhëheqësi i Pajtueshmërisë, Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm apo tek një anëtar i Bordit Menaxhues; ose***
- ***Të raportoni sipas Politikës së Sinjalizuesit.***

Asnjë veprim hakmarrës apo i kundërt nuk do të merret ndaj punonjësit që raporton, ankohet për-, ose merr pjesë në një hetim të një shkeljeje të mundshme të Kodit të Mirësjelljes, ligjeve të aplikuara ose dokumenteve të brendshme të bankës.

Ukshin Hoti Str. nr. 128,  
Prishtinë 10000, Kosovë

informata@bpbbank.com  
038 620 620 | 0800 50000

**[www.bpbbank.com](http://www.bpbbank.com)**



Banka e vendit tënd